



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:102097
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05718787

CA.nr.5375/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ardian Ajvazi, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Hysni Bardheci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të palës së mbrojtur E..... R....., nga Gjilani me vendbanim në Rr. Vëllezërit Hyseni, nr.82, të cilin e përfaqëson mbrojtësi i viktimave G...L....., Zyrtar Ligjor në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (në vijim ZMNV) në Prokurorinë Themelore të Shtetit në Gjilan, kundër palës përgjegjëse A..... R..... nga Gjilani, me vendbanim në Rr. M..... A.... B....., nr.28, për shkak të lëshimit të urdhërit për mbrojtje, duke vendosur sipas ankesës së palëve ndërgjyqëse të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3105/2024, të datës 05.04.2024, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur me datë **22.05.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHEN si të pa bazuara ankesat e palës së mbrojtur E..... R....., nga Gjilani dhe palës përgjegjëse A..... R..... nga Gjilani, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm C.nr.3105/2024, i datës 05.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Gjykata e shkallës së parë me Aktvendimin e atakuar C.nr.3105/2024, të datës 05.04.2024, ka vendosur në këtë mënyrë: **I. APROVOHET si e bazuar** kërkesa e palës së mbrojtur E..... R....., nga Gjilani, për lëshimin e urdhërit mbrojtës ndaj palës përgjegjëse A..... R..... nga Gjilani, me vendbanim në Rr. M..... A... B....., nr.28. **II.** Urdhërohet pala përgjegjëse A..... R..... nga Gjilani, të ndërpresë dhe të mos përsërisë asnjë veprim të dhunshëm ndaj palës së mbrojtur E..... R..... nga Gjilani, personave në marrëdhënie familjare me të, kafshëve shtëpiake apo të mos e dëmtojë pasurinë. **III.** I ndalohet palës përgjegjëse A..... R.... nga Gjilani, që në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes personave të tretë apo çfarëdo lloj mënyre tjetër të komunikimit të ngacmojë, shqetësojë, manipulojë, ofendojë, kërcënojë, përndjekë apo vëzhgojë palën e mbrojtur dhe personat në marrëdhënie familjare me atë. **IV.** Urdhërohet pala përgjegjëse A..... R....., që mos t'i ofrohet palës së mbrojtur E..... R....., në distancë jo më

të afërt se 50 metra nga vendi ku banon në Rr. “Vëllezërit Hyseni”, nr. 82, si dhe 20 metra në pjesë të ndryshme të qytetit. **IV.** Ky urdhër mbrojtës caktohet në afat prej 4 muaj, duke llogaritur nga data 05.04.2024 deri më datën 04.08.2024, me mundësi të vazhdimit të tij, por jo më shumë se njëzet e katër (24) muaj. **V.** Caktohet masa mbrojtëse e shoqërimit të palës së mbrojtur me qëllim të marrjes së gjësendeve personale. **VI.** Caktohet masa mbrojtëse mbajtja financiare për palën e mbrojtur dhe fëmijët në shumë prej 400€ në muaj, duke filluar nga data deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për një gjë të tillë. **VII.** Gjatë periudhës së këtij urdhëri mbrojtës, fëmijët e mitur Ajan Rudi i lindur me datë 09.01.2014, A.... R.... i lindur me datë 01.05.2019 dhe Aissea Rudi e lindur me datë 13.11.2021 që të tre nga nëna E..... R..... dhe babai A..... R....., përkohësisht i besohen në ruajtje, kujdes dhe edukim të mëtutjeshëm nënës së tyre biologjike, këtu palës së mbrojtur E.....R....., ndërsa pala përgjegjëse A..... R....., kontaktin personal me fëmijët e mitur, si baba i tyre, do ta realizoj 2 (dy) herë në javë, çdo të hënë dhe të enjte nga pesë (5) orë në ditë, prej orës 13:00, deri në ora 18:00, fëmijët do ti merr në Rr.“L.... S....” pa numër, fëmijët do ti dorëzon vëllai i palës së mbrojtur dhe po ai do ti pranojë në orarin e cekur si më lartë. **VIII.** Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk e shtyen ekzekutimin e këtij Urdhëri mbrojtës. **IX.** Shkelja e këtij urdhëri mbrojtës është vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare. **X.** Organ kompetent për ekzekutimin e këtij aktvendimi është Policia e Kosovës- Stacioni Policor në Gjilan.

Kundër këtij Aktvendimi pala e mbrojtur më afat ligjor ka parashtruar ankesë, për shkak vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtës materiale me propozim si në të njëjtin.

Kundër këtij Aktvendimi pala përgjegjëse në afat ligjor ka parashtruar ankesë për shkak vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të drejtës materiale me propozim si në të njëjtin.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe vlerësimit të komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e palëve ndërgjyqëse është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se pala e mbrojtur me datë 02.04.2024 ka parashtruar kërkesë për lëshimin e urdhërit për mbrojtje kundër palës përgjegjëse, me kërkesë që të caktohet urdhri mbrojtës dhe masat mbrojtëse si në kërkesë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas kërkesës për urdhër mbrojtje, pas mbajtjes së sencës gjyqësore dhe administrimit të provave të propozuara, me aktvendimin e atakuar. Ndër të tjera në arsyetimin e Aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar këto prova: Raportin ditor të dhunës familjare, me numër të rastit 2024-CA-459, të datës 30.03.2024, Kallëzimin penal, me numër të rastit 2024-CA-0459, të datës 30.03.2024, Raportin e policisë me numër 2024-CA-0459, të datës 30.03.2024, Raportin fillestar të incidentit, me numër të rastit 2024-CA-0459, të datës 30.03.2024, Aktvendimin e Prokurorisë Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të

Rënda, të datës 30.03.2024, Informacionet e personit të dyshuar, nga Policia e Kosovës, Raportin mjekësor nga Spitali i Përgjithshëm, të datës 30.03.2024, Procesverbalin e marrjes në pyetje për personin e dyshuar, të datës 30.03.2024, Procesverbalin e marrjes në pyetje të dëmtuarin, të datës 30.03.2024, Procesverbalin e marrjes në pyetje të dëshmitarit Sh..... R....., të datës 30.03.2024, Forma bazike e të dhënave për viktimat e dhunës në familje, Fotografitë e palës së mbrojtur, Kartela e viktimës, e datës 30.03.2024, Raporti i oficerit, i datës 30.03.2024, Kërkesë për caktimin e paraburgimit nga Prokuroria Themelore në Gjilan, me numër PP.II.nr.455/24, të datës 31.03.2024, Aktvendimin për fillimin e hetimeve, PP.II.nr.455/2024, të datë 31.03.2024, Procesverbalin e marrjes në pyetje të të dëmtuarës në prokurori, me numër PP.II.nr.455/2024, datë 02.04.2024. Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptimin e nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që: Gjykata, nga pohimet e vet palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave veç e veç, e së bashku, ka vërtetuar se mes palëve nuk ishte kontestues fakti se pala e mbrojtur me palën përgjegjëse me datë 30.03.2024 rreth orës 12:00 ka pasur një konflikt fizik në mes vete, ku pas një konflikti verbal të palës së mbrojtur me nënën e palës përgjegjëse, me të kuptuar rastin pala përgjegjëse e sulmon fizikisht palën e mbrojtur duke e goditur në fytyrë me shuplaka me çrast pala e mbrojtur është detyruar të kërkojë ndihmë mjekësore në SPGJ. Faktet kontestuese gjykata i zgjidhi me administrimin e provave materiale të propozuara nga pala e mbrojtur, të cilat ishin në përputhje me njëra – tjetrën dhe në të gjitha këto prova përshkruhej gjendja e njëjtë faktike, por edhe nga deklarimi i bërë në seancën dëgjimore të datës 05.04.2024 të palës përgjegjëse. Andaj, duke u bazuar në gjendjen faktike si më lartë, gjykata ka vërtetuar faktin se me veprimet e palës përgjegjëse janë manifestuar elemente të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur, të cilat konsistojnë edhe në dhunë fizike dhe psikike. Gjykata, deri te ky konstatim ka ardhur në bazë të provave të administruara dhe nga deklaratimet dhe pohimet e palëve ndërgjyqëse gjatë seancës së mbajtur me datë 05.04.2024, pasi që pala përgjegjëse përveç faktit që ka përdorur dhunë fizike dhe psikike i ka shkaktuar shqetësim të madhë emocional palës së mbrojtur, andaj gjykata vlerëson se me këto veprime te pala e mbrojtur ka shkaktuar ndjenjën e frikës, rrezikshmërisë personale, cenimit të dinjitetit, pasqurisë dhe shqetësimit. Duke qenë se ishte jo kontestues fakti se palët ndërgjyqëse në këtë procedurë ishin bashkëshortë në njërin anë e në anën tjetër gjykata duke u bazuar në nenin 2, në të cilin përkufizohet se çka nënkupton marrëdhënia familjare, konkretisht paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 pika 1.1.5. përdorin një shtëpi të përbashkët...”LMDHF-ës, konstatoi se janë plotësuar kushtet formale juridike për të vendosur lidhur me këtë çështje, për shkak të njëjtë kanë bashkëjetuar. Lidhur me elementet e dhunës, në nenin 2 paragrafi 1, pika 1.2, përkufizohet se cilat elemente i përmban dhuna në familje ashtu që *“Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bëjnë një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: 1.2.1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; 1.2.2. çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; 1.2.3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimit të dinjitetit”, lidhur me nenin 5 pika 1 dhe 2, si dhe nenin 6.1, nenin 18 pika 1 dhe 2, nën pika 1.2, 1.3, 1.4 si dhe nenin 19 pika 3, 24,25,26 dhe nenin 34 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, pasi që në rastin konkret u vërtetua se është përdorur presion psikik ndaj palës së mbrojtur, me çka është shkaktuar ndjenja*

e frikës, rrezikshmërisë personale dhe cënimi i dinjitetit tek e njëjta, mbi bazën e të lartëcekurave gjykata vendosi të aprovojë masat e propozuara, dhe vendosi si në pikën **I, II, III dhe IV, V dhe VI dhe VII, VIII, IX dhe X** të dispozitivit të këtij aktvendimi. Gjykata vlerëson se me shqiptimin e këtyre masave do të arrihet qëllimi i këtij ligji, i cili konsiston në parandalimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj nga pala përgjegjëse, ndërsa për palën e mbrojtur, këto masa do t'i mundësojnë siguri për një periudhë të caktuar kohore, gjegjësisht një jetë pa frikë nga dhuna e mëtejme apo edhe rehabilitim nga pasojat-traumat eventuale, të cilat mund t'i kenë pasur ajo, andaj gjykata konsideron se masat e shqiptuara me këtë aktvendim për momentin janë të mjaftueshme dhe se me to do të arrihet qëllimi i lëshimit të këtij urdhri mbrojtës. Lidhur me provat të cilat ka propozuar që të administrohen nga pala përgjegjëse, të njëjtat nuk provojnë ndonjë fakt vendimtar lidhur me ngjarjen e ndodhur në natën kritike, pra datë 31.12.2022. Andaj, gjykata nga të lartcekurat, duke përfshirë gjendjen faktike dhe dispozitatat nga LMDHF-së, lidhur me nenet 2 dhe nenit 142 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson Aktvendimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, por as me shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit NR. 08/L-185.

Gjykatës së Apelit i rezultoi se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në Aktvendimin e atakuar lidhur me caktimin e urdhrin mbrojtës dhe masat tjera ka ndjekur qëllimin e **LIGJI NR. 08/L-185 PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DHUNA NË FAMILJE DHUNA NDAJ GRAVE DHE DHUNA NË BAZA GJINORE**, i cili është parandalimi i dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat të dhunës në familje. Në këtë kontekst, gjykata ankimore vlerëson se nga gjendja faktike e konstatuar e cila është provuar përmes mjeteve provuese të administruara në procesin gjyqësor dhe është përshkruar nga gjykata e shkallës së parë konfirmohet në mënyrë të besueshme se akti i dhunës në familje ka ndodhur dhe rrjedhimisht diktohet nevoja e caktimit të urdhrin me masat e përshtatshme për parandalimin e dhunës në familje, si dhe rehabilitimin e pasojave të shaktuara nga dhuna në familje. Në rastin konkret veprimet e kryerësit të dhunës në familje kualifikohet si dhunë në kuptim të nenit 3 të **LIGJI NR. 08/L-185**, marrë parasysh faktin se dhuna në familja ka ndodhur me datë 30.03.2024, ndërsa ky ligj ka hyrë në fuqi e datë 28.10.2023.

Duke qenë se është provuar akti i dhunës, gjykata ankimore vlerëson se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur për caktimin e urdhrin të mbrojtjes, si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar. Në këtë rast gjykata ankimore vlerëson se caktimi i urdhrin është përfundim i drejtë dhe i ligjshëm i gjykatës së shkallës së parë, i mbështetur në dispozitat ligjore të cekura më lartë dhe mbi këtë vlerësim është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e vërtetuar në tërësi të njëjtin.

Në çdo rast urdhrat e caktuar nga gjykata, kanë karakter të përkohshëm, ashtu edhe siç janë procedurat urgjente për vendosjen e tyre, ndërsa kjo nuk do të jetë pengesë që me rastin e vendosjes në procedura tjera të rregullta, gjykata mund të ketë vlerësim ndryshe për çështjet e gjykuara në procedurën për lëshimin e urdhër mbrojtës. Në të njëjtën kohë, LIGJI NR. 08/L-185 i garanton mbrojtje secilit i cili pretendon dhe vërteton praë gjykatës se ndaj tij është ushtruar dhunë në familje.

Në rastin konkret sipas kërkesës së palës së mbrojtur të datës 02.04.2024, gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë Aktvendimin e atakuar, përmes së cilit është aprovuar pjesërisht kërkesa për urdhërmbrojtje, përkatësisht kërkesa për mbajtja financiare që është kërkuar fillimisht nga 150.00 Euro për secilin fëmijë të mitur dhe 150.00 euro për palën e mbrojtur, (4x150=600.00 Euro), ndërsa 200.00 euro i ka kërkuar në emër të pagesës së qirasë. Gjkata e shkallës së parë këtë kërkesë e ka aprovuar pjesërisht si në dispozitiv të Aktvendimit të atakuar, ndërsa nuk ka vendosur për refuzimin e pjesës tjetër edhe pse këtë shkelje procedurale e ka vërejtur Gjkata e Apelit, nuk e ka kthyer rastin në rigjykim për shkak se kontestet e tilla janë të ndieshme dhe kërkojnë vendimarrje të shpejt, shtu këtu faktin me rëndësi se dispozitivi i Aktvendimit të atakuar është i përshtatshëm për përmbarim ashtu siç wshtw vendosur dhe me vendimarrjen e gjykatës së shkallës së parë pajtohet Gjkata e Apelit. Pra ky lëshim procedural i gjykatës së shkallës së parë nuk ka ndikuar në vendimarrje dhe për këtë arsye Aktvendimi i atakuar është vërtetuar. Po ashtu në dispozitiv VI të Aktvendimit të atakuar nuk është caktuar data e ekzekutimit të masës mbrojtëse financiare, ajo duhet të jetë nga data e nxjerrjes së Aktvendimit të atakuar (05.04.2024).

Gjkata e Apelit i ka vlerësuar edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të palëve ndërgjyqëse të paraqitura me ankesë, mirëpo të njëjtat ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe në këtë çështje juridike.

Nga arsyet e cekuar Gjkata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, andaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

CA.nr.5375/2024, datë 22.05.2024

**Kryetari i kolegjit,
Ardian Ajvazi**